


# Indeksi i Çmimeve të Konsumit

## Gusht 2023

**Tiranë, më 08 Shtator 2023:** Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Gusht 2023, arriti 114,5 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2023 është 4,0 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 8,0 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2023, krahasuar me Korrik 2023 është 0,6 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




### Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Gusht është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +2,78 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,44 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,43 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,23 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,20 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Veshje dhe këpucë” me +0,16 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,09 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shëndeti” dhe “Shërbimi arsimor” me +0,06 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,03 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,66 pikë përqindje.

**Për publikim 08/09/2023**

**Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor**



**Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Gusht 2022, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 7,8 %, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 5,9 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 5,0 %, “Veshje dhe këpucë” me 4,4 %, “Argëtim dhe kulturë” me 3,9 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,7 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,2 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 2,3 %, “Shërbimi arsimor” me 2,2 %, “Shëndeti” me 1,3 % dhe “Komunikimi” me 1,1 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 10,0 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 20,8 %, pasuar nga nëngrupet “mish” me 9,6 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 9,1 %, “fruta” me 7,7 %, “peshk” me 5,3 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 3,5 %, “bukë dhe drithra” me 2,3 %, etj.

**Ndryshimet mujore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Korrik 2023, çmimet e grupit “Transporti” u rritën me 2,8 %, pasuar nga çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,1 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,4 % secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,3 %, “Shëndeti”, “Shërbimi arsimor” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,2 % secili, “Komunikimi” dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0,1 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u ulën me 0,1 %.

**Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit**

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	08-22	09-22	10-22	11-22	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23	08-23
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>110,1</b>	<b>110,8</b>	<b>111,2</b>	<b>110,9</b>	<b>111,4</b>	<b>112,6</b>	<b>113,9</b>	<b>114,7</b>	<b>114,7</b>	<b>114,3</b>	<b>114,0</b>	<b>113,8</b>	<b>114,5</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	35,6	118,0	119,3	119,8	119,7	121,4	124,5	128,7	130,8	130,5	129,0	127,4	126,7	127,2
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	107,4	107,7	107,3	107,4	107,7	108,2	108,6	109,2	109,8	110,3	110,3	110,8	110,8
3	Veshje dhe këpucë	3,6	102,0	104,2	104,7	105,2	105,6	105,5	105,3	105,3	105,4	105,8	106,2	106,7	106,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,5	104,2	104,4	105,0	104,8	104,8	105,1	105,1	105,2	105,2	105,4	105,4	105,4	106,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	105,4	106,3	107,2	107,3	107,7	108,0	108,7	109,3	110,3	110,7	111,0	111,2	111,6
6	Shëndeti	4,2	101,3	101,6	102,0	102,1	102,0	101,9	102,0	102,0	102,2	102,2	102,3	102,5	102,7
7	Transporti	6,4	125,3	123,2	125,0	119,0	115,6	116,4	113,1	112,0	110,7	109,3	109,0	109,8	112,8
8	Komunikimi	3,1	103,9	103,9	103,8	104,4	104,6	104,6	104,6	104,7	104,9	104,9	104,9	104,9	104,9
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	106,7	107,0	104,3	105,0	105,6	106,0	106,3	108,0	108,5	109,9	111,8	110,8	110,9
10	Shërbimi arsimor	3,0	100,9	102,6	102,2	102,5	102,8	102,9	102,9	102,8	102,9	103,0	103,0	103,0	103,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,5	107,6	108,0	108,1	108,7	108,7	109,4	109,5	110,0	110,4	111,4	111,8	112,5	113,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	101,8	102,7	103,0	103,1	103,0	103,3	103,6	103,9	104,6	105,0	105,2	105,4	105,6

**Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (%)**

Kodi	Grupet	08-22/08-21	09-22/09-21	10-22/10-21	11-22/11-21	12-22/12-21	01-23/01-22	02-23/02-22	03-23/03-22	04-23/04-22	05-23/05-22	06-23/06-22	07-23/07-22	08-23/08-22
	<b>Gjithsej</b>	<b>8,0</b>	<b>8,1</b>	<b>8,3</b>	<b>7,9</b>	<b>7,4</b>	<b>7,2</b>	<b>7,1</b>	<b>5,3</b>	<b>4,6</b>	<b>4,7</b>	<b>4,5</b>	<b>4,2</b>	<b>4,0</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	14,0	14,0	14,6	14,7	14,2	13,3	13,5	11,0	9,6	10,0	10,3	9,0	7,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	6,2	6,5	5,7	5,8	5,5	5,1	5,1	2,8	3,8	3,7	3,7	3,8	3,2
3	Veshje dhe këpucë	1,9	3,0	3,0	3,6	3,8	4,1	4,4	3,7	3,9	4,2	4,4	4,3	4,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	3,2	3,3	3,6	3,1	2,8	3,0	3,1	2,6	2,3	2,2	2,1	1,3	2,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	4,7	5,5	6,5	6,2	6,5	6,4	6,9	6,6	6,7	6,5	6,2	6,0	5,9
6	Shëndeti	0,6	0,9	1,3	1,3	1,1	1,0	1,0	1,1	1,4	1,4	1,2	1,1	1,3
7	Transporti	19,3	17,2	16,9	9,6	6,0	6,5	1,7	-7,5	-10,7	-12,3	-16,2	-12,4	-10,0
8	Komunikimi	0,9	0,9	0,7	1,1	1,3	1,3	1,2	1,4	1,2	1,2	1,4	1,2	1,1
9	Argëtim dhe kulturë	5,2	4,7	1,7	1,0	1,3	1,8	3,4	4,7	2,4	6,9	10,3	9,5	3,9
10	Shërbimi arsimor	0,7	1,8	1,8	1,9	2,3	2,3	2,3	2,0	2,1	2,2	2,2	2,0	2,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	6,2	6,4	6,1	6,1	5,2	5,6	5,5	4,6	4,5	5,0	4,8	5,0	5,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	1,9	2,9	3,3	3,6	3,3	3,6	3,2	3,2	3,6	4,0	4,0	3,7	3,7

**Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (%)**

Kodi	Grupet	08-22	09-22	10-22	11-22	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23	08-23
	<b>Gjithsej</b>	<b>0,8</b>	<b>0,6</b>	<b>0,4</b>	<b>-0,3</b>	<b>0,4</b>	<b>1,1</b>	<b>1,1</b>	<b>0,7</b>	<b>0,0</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,1</b>	<b>0,6</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,5	1,1	0,4	-0,1	1,5	2,6	3,3	1,7	-0,2	-1,2	-1,2	-0,6	0,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,6	0,3	-0,4	0,1	0,2	0,5	0,3	0,6	0,5	0,4	0,0	0,4	0,0
3	Veshje dhe këpucë	-0,2	2,1	0,5	0,5	0,3	-0,1	-0,2	0,0	0,1	0,5	0,4	0,4	-0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,2	0,2	0,6	-0,2	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	1,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,4	0,9	0,8	0,2	0,3	0,3	0,7	0,6	0,9	0,3	0,3	0,2	0,3
6	Shëndeti	0,0	0,3	0,4	0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,0	0,3	0,0	0,0	0,2	0,2
7	Transporti	0,0	-1,7	1,5	-4,8	-2,8	0,7	-2,8	-1,0	-1,1	-1,2	-0,3	0,7	2,8
8	Komunikimi	0,2	0,0	0,0	0,5	0,2	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	0,1
9	Argëtim dhe kulturë	5,5	0,3	-2,5	0,7	0,5	0,4	0,3	1,6	0,5	1,2	1,8	-0,9	0,1
10	Shërbimi arsimor	0,0	1,6	-0,4	0,3	0,4	0,0	0,0	-0,1	0,1	0,1	0,0	0,0	0,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,4	0,4	0,1	0,5	0,0	0,6	0,2	0,4	0,4	0,9	0,3	0,6	0,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,3	0,9	0,2	0,1	-0,1	0,2	0,3	0,3	0,6	0,4	0,2	0,2	0,2

# Metodologjia

## Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2021.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

## Përkufizime

**Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)** është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.